

---

**STATUTI**  
**i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar**  
**"ARRA GROUP" SH.P.K.**

Parashikimet e ketij Statuti zbatohen per nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (SHPK).

Ne kete statut:

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008 "Per Tregtare dhe Shoqerite Tregtare" i azhornuar;
- "Statuti" eshte Statuti i shoqerise;
- QKB" -Qendra Kombetare e Biznesit ne Shqiperi.

**KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Sella**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Me date 27.04.2024 ne te nenshkruarit: Samir Shumetaj i datelindjes 25.02.1992 i pajisur me karten e identitetit J202250971, dhe Sylejman Gashi i datelindjes 21.08.1966 i pajisur me karten e identitetit 1005910923, regjistrojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "ARRA GROUP" Sh.p.k., bazuar ne akt themelimin e dates 27.04.2024.

**Neni 2**

**Objekti**

2.1 Aktivitetet te sherbimit te pijeve, Import/eksporti i pijeve alkalike dhe joalkolike.

Gjithashtu shoqeria mund te ushtroj edhe cdo lloj aktiviteti tjeter te pashprehur me siper, qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

**Neni 3**

**Kohezgjatja**

3.1. Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pacaktuar.

#### **Neni 4**

##### **Selia**

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në Fier në adresën: Sheq i madh Fier, rruga për Metalli, zona kadastrale nr.3981

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e tij, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## **KREU II**

### **Kapitali**

#### **Neni 5**

##### **Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali fillestar i kompanisë do të jetë 100 (nëqind) leke të ndarë në 2 kuota me vlerë nominale 100 leke e cila zotërohet nga ortakët Samir Shametaj 1 kuota 50 leke dhe Sylejman Gashi 1 kuota 50 leke.

5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

#### **Neni 6**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjten masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

- b) shitblerjes;
  - c) trashëgimise;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve; për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 7.3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarres

- 8.1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.
- 8.2. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
  - ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - g) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4. Ortaku mund të përfaqësohet në asambletë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asambletë e përgjithshme.
- 8.6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblese së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**

##### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

9.1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

9.2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

#### **Neni 10**

##### **Kuorumi**

10.1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

10.2. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

10.3. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mbledhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mbledhet perseri jo me vonë se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### **Neni 11**

##### **Marrja e vendimeve**

11.1. Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

11.2. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

11.3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## **Neni 12**

### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

12.1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

12.2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

## **Neni 13**

### **Administrimi**

13.1. Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripeteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas Biznesit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

13.2. Administrator caktohet Z. Samir Shametaj me afat 5 vjet nga data 27.04.2024 deri me 27.04.2029.

## **Neni 14**

### **Kompetencat e Administratoreve**

14.1. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercejnejo mbarëvajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
- e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

e) kryejn detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:  
-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktiviteti dhe shoqëria nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.  
-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë me të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas Biznesit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë me të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

14.3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

14.4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

15.1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tjerëve, për shkeljet të ligjeve, për shkeljet të statutit, apo për fajet të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

15.2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

15.3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nenëve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administrator detyrohet:

15.3.1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në keto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe menjajtojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

15.3.2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

15.3.3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshpërblejë shoqërisë

demit, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

15.4. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demit e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;
- ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aflesi paguese per te shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

15.5. Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit. Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

#### **KREU IV** **Viti financiar-ekspertet**

##### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

16.1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e Biznesit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17**

##### **Ekspertet**

17.1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike

ne nashtruar, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

## KREU V

### Prishja –riorganizimi i shoqerise

#### Neni 18

##### Prishja dhe likuidimi

18.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";
- d) me vendim te gjykates;

18.2. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emeratesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

18.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

18.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

18.5. Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

#### Neni 19

##### Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

19.1. Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

#### Neni 20

##### Baza Ligjore


20.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.



20.2 Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

ORTAKET E SHOQERISE

  
SYLEJMAN GASHI

  
SAMIR SHAMETAJ